



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punimjeve/Protokolle Received/Delivered	11.08	2022	2	viti god year
Organ /Rrjeta Organ /Jednica Org./Unit	No Prot Br.Pr./ Prot.No	Status - Fjalor/ Approva	Sasia Kolicina Quantity	
SIKIP/HCIL	4658/2022		1/5	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.643/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.643/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga

në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. Prto:1521 të datës 24.06.2022 të Drejtorit të Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim në Zyrën e Kryeministrit, në çështjen juridike "masë disiplinore-vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.643/2022 e datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Prot:1521 i datës 24.06.2022 i Drejtorit të Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim në Zyrën e Kryeministrit.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Zyrën e Kryeministri, fizikisht më datë 21.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolle 4231/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Prot:1521 të datës 24.06.2022 të Drejtorit të Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim në Zyrën e Kryeministrit, për shkak të shkeljeve procedurale dhe mos konstatim të drejtë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Zyrën e Kryeministrit, ndërsa Këshilli më datë 29.07.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4231/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prto:1521 i datës 24.06.2022 i Drejtorit të Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim në Zyrën e Kryeministrit; Emailin e datës 25.05.2022 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 25.05.2022 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 23.05.2022 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 23.05.2022 nga ankuesja për [redacted] Raporti i vijueshmërisë së punë për periudhën 13-24.06.2022 për ankuesen; Emailin e datës 17.06.2022 nga ankuesja për [redacted] Emailin e datës 28.06.2022 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 01.04.2022 dhe 30.03.2022 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 01.04.2022 dhe 30.03.2022 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 07.07.2022, 05.07.2022 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 13.06.2022 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 13.06.2022 nga [redacted] Raportin nga Shërbimi Spitalin dhe Klinik Universitar i Kosovës i datës 20.06.2022; Raport nga Spitali Special për Urologji VITA HOSPITAL, i datës 21.06.2022; Raport nga Spitali ALOKA i datës 21.06.2022, 22.06.2022; Emailin e datës 22.06.2022 nga ankuesja për [redacted] Emailin e datës 27.06.2022 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 26.06.2022 dhe 23.06.2022 nga ankuesja për [redacted] Fletë lëshimin nga Spitali ALOKA i datës 25.06.2022; Raportin nga Spitali ALOKA i datës 28.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.07.2022; Akt Emërimit AE.Nr.43/2021 të ankueses; Raportin e prezencës në punë për periudhën 20-24.05.2022 për ankuesen; Emailin e datës 28.06.2022 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 27.06.2022 ora 3:52 dhe 8:34 nga ankuesja për [redacted] Emailin e datës 27.06.2022 nga ankuesja për [redacted] Emailin e datës 29.06.2022 për ankuesen nga [redacted] Emailin e datës 29.06.2022 nga ankuesja për [redacted]

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se ankesën e parashtruar nga ankuesja, është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur që ankuesja në bazë të Akt Emërimit AE.Nr.43/2021 të datës 22.06.2021 është e punësuar në pozitën Zyrtare e Lartë për Asistencë Zhvillimore në Zyrën e Kryeministrit.

Drejtori i Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim në Zyrën e Kryeministrit, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit më datë 24.06.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. Port: 1521 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje", me arsyetim [redacted] më datat 20 maj 2022 dhe 23 maj 2022 ka pasur mungesa dhe vonesa brenda orarit të punës si dhe mos regjistrim në sistemin elektronik të vijueshmërisë...kam mbajtur takim me [redacted] me ç'rast kam kërkuar respektimin e orarit të punës dhe marrjen e lejes për çdo vonesë ose mungesë në vendin e punës, njëkohësisht përmes emailit zyrtar të datës 25 maj 2022 të drejtuar te njësia përgjegjëse për burime njerëzore kam arsyetuar mungesat dhe vonesat paraprake. Pavarësisht kësaj gjatë ditëve të punës në javën 13-17 dhe 20-24 qershor 2021 përmes kontrollit të sistemit të vijueshmërisë është evidentuar se

ka pasur vonesa dhe mungesa në vendin e punës nga [redacted] të cilat nuk janë arsyetua asnjëherë, përkatësisht nuk është marr leje paraprake për këto vonesa dhe mungesa ore nuk ka dëshmi të vijueshmërisë date, për shkak të mos regjistrimit në sistemin elektronik të vijueshmërisë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimit me Nr. Prto:1521 të datës 24.06.2022 të Drejtorit të Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim në Zyrën e Kryeministrit për shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje", pretendon që masa disiplinore është shqiptuar si rezultat i reagimit tek Zëvendësuesi i Sekretarit të Zyrës së Kryeministrit lidhur me mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit të punëve nga udhëheqësi, masa disiplinore nuk është baraspeshuar më demin për shkak që nuk është shkaktuar asnjë dëm si rezultat i mungesave në orar, sepse më datë 15 qershor nuk ka evidentim të mungesës në punë por ka mos evidentim që ka ndodhur për shkak të harresës,, më datë 16, 17 dhe 20 qershor mund të vërtetohet se kam qëndruar në punë pas orarit, më datë 21 qershor 20202 vonesa ka rezultuar si shkak i një emergjence familjare, më datë 22 qershor 20202 mungesa i është përcjell burimeve njerëzore më datë 23 dhe 24 qershor 2022 burimet njerëzore janë njoftuar me kohë për mungesën dhe mos paraqitjen në vendin e punës, andaj ditën që më është shqiptuar masa kam pasur rast familjar dhe nuk më është dhënë mundësia për diskutim dhe arsyetim të gjendjes lidhur me mos paraqitjen në punë, prandaj masa nuk është në proporcion me shkeljen sepse fillimisht duhet shqiptuar vërejtje me gojë pastaj me shkrim.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesja më datë 20.05.2022 është evidentuar në punë në hyrje më datë 09:19, ndërsa nuk është evidentuar në dalje, ndërsa më datë 23.05.2022 e njëjta nuk është evidentuar në hyrje por është evidentuar në dalje në orën 16:24, kurse më datë 23.05.2022, ankuesja është njoftuar për këto mungesa, mirëpo udhëheqësi i drejtpërdrejt përmes emailit të datës 25.05.2022 ka njoftuar divizionin e burimeve njerëzore që pas bisedës që ka pasur me ankuesen për këto mungesa/vonesa për datë 20 dhe 23 maj 2022 ka theksuar që ka arsyetim për këtë, mirëpo ka njoftuar që orari i punës duhet respektuar për këtë është njoftuar edhe ankuesja përmes emailit të datës 23.05.2022, ku udhëheqësi i drejtpërdrejt ka qenë i njoftuar.

Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me Nr. Prot:1521 të datës 24.06.2022 të Drejtorit të Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim në Zyrën e Kryeministrit për shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje" dhe pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton që në bazë të raportit të prezencës në punës për periudhën 13-24.06.2022 për ankuesen, shihet që e njëjta më datë 13.06.2022 ka bërë hyrje në vendin e punës në orën 10:05 ndërsa dalje nuk ka bërë fare, më datë 14.06.2022 ka bërë hyrje në orën 08:37 ndërsa dalje ka bërë në orën 16:15, më datë 15.06.2022 ka bërë hyrje në orën 08:39 ndërsa dalje nuk ka bërë fare, më datë 16.06.20202 ka bërë hyrje në orën 08:23 ndërsa dalje në orën 16:42, më datë 17.06.2022 ka bërë hyrje në orën 08:40 ndërsa dalje ka bërë në orën 16:22, më datë 20.06.2022 ka bërë hyrje në orën 08:29 kurse dalje ka bërë më datë 18:04, më datë 21.06.2022 hyrje ka bërë në orën 09:30 ndërsa dalje ka bërë në orën 16:40, më datë 22.06.2022 hyrje ka bërë në orën 08:59 ndërsa dalje nuk ka bërë fare. Bazuar në provat e lëndës, udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankueses më datë 13.06.2022 ka njoftuar burimet njerëzore që ankuesja më lejen e tij ka shkuar më herët në shtëpi për arsye shëndetësore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ju referua Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht nenit 4 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *“Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premtën”*, si rrjedhojë ankuesja përveç që më datë 13.06.2022 i është lejuar të dal më herët në punë, e njëjta përveç që ka ofruara raportin nga Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës të datës 20.06.2022, Raportin nga Spitali Special për Urologji VITA HOSPITAL i datës 21.06.2022, Raportin nga Spitali ALOKA i datës 21.06.2022, 22.06.2022, Fletë lëshimin nga Spitali ALOKA i datës 25.06.2022 dhe Raportin nga Spitali ALOKA i datës 28.06.2022 e të cilat raporte kanë të bëjnë me një familjar të ankueses, e njëjta nuk ka ofruar asnjë provë relevante me të cilat do të vërtetonte që për këto vonesa apo mos evidentime në sistemin elektronik të hyrje/daljeve në punë të ketë njoftuar udhëheqësin e drejtpërdrejt. Përveç që *gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik* siç parashihet me nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, andaj Kolegji konstaton se për *çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje menaxherit drejtues*, siç parashihet me nenin 8 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, kështu që *mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore* siç parashihet me paragrafin 2 të nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Nisur nga rrethanat si me lartë Kolegji, vlerëson se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *“Vërejtje”* sipas Vendimit me Nr. Prot:1521 të datës 24.06.2022, ka konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankueses si dhe ka cilësuar drejtë veprimet e ankueses si shkelje të lehtë disiplinore siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë si dhe nenin 48 paragrafi 2 të të njëjtit ligj më të cilin është përcaktuar se: *“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”*, sepse zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1, 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke e arsyetuar vendimin në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht me nenin 48 paragrafi 1 dhe të 2, andaj sa i përket pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se të gjitha pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuar dhe të paqëndrueshme sepse e njëjta nuk i ka argumentuar me prova relevante.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.643/2022

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.